

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6919  
E hënë, 12 qershor 2023  
Çmimi 0.40

Kosova dhe NATO,  
bashkëluftëtarë në  
rrugën e bërjes së  
kombit shqiptar | FAQE 3

Prof. dr. Kudusi  
LAMA, gjeneral  
në pension



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ESCOBARI BËN THIRRJE QË TË DYJA PALËT T'I KTHEHEN ZBATIMIT TË MARRËVESHJES SË OHRIT

| FAQE 3

I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, e ka cilësuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, partner i ShBA-së, ani pse ka thënë se ai nganjëherë është "partner i vështirë". Ai ka përsëritur sërish se të dyja palët, Kosova dhe Serbia, duhet t'i kthehen zbatimit të marrëveshjes së Ohrit. "Ne duhet të gjejmë një mënyrë për t'i depërkallëzuar proceset menjëherë, për ta depërkallëzuar situatën dhe menjëherë të kthehemi në fokusin e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit", ka theksuar Escobari. Ndërkaq kryeministri Kurti ka thënë të dielën se rruga për qetësimin e situatës në veri duhet të nisë me largimin e bandave kriminale atje



## VENDOSËT PLLAKË PËRKUJTIMORE NË SHTËPINË E SHASIVAR MAKOLLIT, VLERËSOHET LART KONTRIBUTI I TIJ PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE | FAQE 3



## NË 24-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË PRISHTINËS, USHTARAKËT E FSK-së SË BASHKU ME FËMIJËT PARAKALUAN SHESHEVE TË KRYEQYTETIT | FAQE 5


### AKTUALE



## SHQIPËRI, EMIGRIMI I FËMIJËVE TË PASHOQËRUAR NË VENDET E BE-së, FENOMEN SHQETËSUES | F. 2

## MINISTRI ÇEKU: SERBIA PO SHFAQ MOSDURIM NACIONAL NË LUGINË TË PRESHEVËS | F. 6

## POLICIA KONFISKON PAJISJE PËR PRODHIM TË KRIPTOVALUTAVE NË ZUBIN POTOK | F. 6



### EKONOMI



## KOMPANI NDËRKOMBËTARE TË INTERESUARA PËR ANKANDIN E PARË SOLAR NË KOSOVË | F. 8

### SPORT



## TOPALLI DHE KRASNIOI: SYNOJMË REZULTATE POZITIVE | F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
[info@kolegji.biznesi.com](mailto:info@kolegji.biznesi.com)  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## BE-ja do t'i ndajë Tunizisë 105 milionë euro për ta frenuar migrimin

**BRUKSEL, 11 QERSHOR** - Bashkimi Evropian do t'i ndajë Tunizisë 105 milionë euro për vitin 2023 për ta frenuar migrimin e parregullt, tha të dielën presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Paratë synojnë ta mbështesin Tunizinë në menaxhimin e kufijve, kërkimin dhe shpëtimin, si dhe kundër operacioneve të kontrabandës, tha Von der Leyen në Tunis. Kjo mbështetje financiare është gati tri herë më shumë sesa mesatarja vjetore e financimit në lidhje me migrimin që BE-ja ndau për Tunizinë në dy vitet e fundit, tha Von der Leyen.

Von der Leyen tha se është interes i përbashkët i BE-së dhe Tunizisë që t'i ndalin kontrabandistët dhe trafikantët me migrantë.

Shefja e Komisionit Evropian i bëri këto komente pas takimit të përbashkët të saj me kryeministren italiane Giorgia Meloni, kryeministrin holandez Mark Rutte dhe presidentin tunizian Kais Saied.

Përfaqësuesit evropianë kanë i çuar përpara përpjekjet që të arrijnë një marrëveshje me Tunizinë që ta parandalojë nisjen e anijeve me migrantë nga territori i saj.



## Shqipëri, emigrimi i fëmijëve të pashoqëruar në vendet e BE-së, fenomen shqetësues

**TIRANË, 11 QERSHOR** - Shqipëria vazhdon të përballlet me një prej fenomeneve më shqetësuese në vitet e tranzicionit, atë të emigracionit. Studiuesit veçojnë në të elementin e azilkërkuesve në vendet e BE-së që, sipas tyre, meriton vëmendje.

Që prej vitit 2012, sipas të dhënave të Eurostatit, në vendet e BE-së kanë kërkuar azil mbi 230 mijë shtetas shqiptarë, mes tyre 66 mijë e 800 fëmijë, ose rreth 28.5%, pjesa më e madhe nën 14 vjeç. Këto shifra në lidhje me fëmijët emigrantë e vendosin Shqipërinë në vendin e pestë, menjëherë pas vendeve që kanë njohur luftëra e konflikte si Afganistani, Siria apo Iraku.

Sipas të dhënave, kjo prirje vazhdoi edhe në vitin 2022. 11 600 shtetas shqiptarë kërkuar azil në vendet e BE-së, 34% e tyre fëmijë. Por për studiuesit fytyra më e trishtuar e këtij emigracioni është ajo e fëmijëve të pashoqëruar.

Sipas Eurostatit, 2 120 fëmijë të pashoqëruar nga Shqipëria kanë kërkuar azil në vendet e BE-së për periudhën 2012-2022. Kjo, sipas studiuesve, e bën Shqipërinë vendin e vetëm evropian me një numër kaq të lartë të fëmijëve emigrantë të pashoqëruar nga familja. "Zëri i Amerikës" bisdoi me një të ri shqiptar në Francë që kërkoi të mbetej anonim. Ai u largua në



moshën 16-vjeçare nga Shqipëria për të kërkuar azil, i pashoqëruar nga prindërit. Arriti ta fitojë atë, ndërsa tregon arsyet pse ndërmori këtë rrugë plot rreziqe. "Bëra shkollën 9 vjeçare dhe nuk kisha mundësi për shkollën e mesme. Edhe po ta vazhdoja, do të merrja një diplomë, gjendje pune Shqipëria nuk ka. Shikoja shokët e mi, kishin vazhduar shkollën e lartë, kishin diplomë, por nuk kishin

punë. Thjesht e kuptova dhe u nisa këtej. U largova nga Shqipëria, të kisha një të ardhme për veten time dhe ta ndihmoja familjen", tha për "Zërin e Amerikës" një i ri në Francë që nuk dëshironte të identifikohet. Ky i ri arriti ta fitojë azilin në Francë, dhe sot në moshën 20-vjeçare punon me një kontratë të rregullt në sektorin e ndërtimit, por ai dhe mjaft të tjerë kanë përshkuar një rrugë të vështirë.

Mbi ta ka rënduar një peshë që e tejkalon moshën e tyre dhe jo të gjithë ia kanë dalë. Ata mbërrijnë në vende të BE-së të pashoqëruar nga prindërit, por në shumicën e rasteve, të nxitur nga ata dhe me miratimin e tyre. Deklarohen në strukturat e vendit pritës si minorenë dhe merren në mbrojtje si të tillë. Kjo rrugë përdoret prej tyre me qëllim përfitimin e dokumenteve të qëndrimit në këto vende më

me lehtësi se një azilkërkues i rritur.

Elda Spaho Bleta, gazetare dhe eksperte komunikimi, e angazhuar vullnetarisht në qendra ku strehohen të mitur të pashoqëruar në Francë, vendi i tretë destinacion në BE për azilkërkuesit, thotë për "Zërin e Amerikës" se fëmijët kanë të njëjtat arsye si të rriturit, kur kërkojnë azil, kryesisht për një të ardhme më të mirë. Por rruga e tyre, siç shprehet ajo, është shpeshherë mjaft e rrezikshme.

Njohës të zhvillimeve shoqërore në Shqipëri konstatojnë se fenomeni i fëmijëve azilkërkues të pashoqëruar e ka burimin te gjendja ekonomike dhe sociale e familjes, varfëria, divorci apo konfliktet e ndryshme.

Gëzim Tushi, sociolog, ngarkon me përgjegjësi strukturat shtetërore që, siç thotë ai, duhet ta parandalojnë këtë fenomen.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës thotë se në bashkëpunim me struktura të tjera shtetërore po punon me familje dhe prindër në komunitet për ndërgjegjësimin e tyre mbi rrezikun që i kanoset fëmijës kur emigron i vetëm. Sipas kryetares së kësaj agjencie, Alma Tandili, po u kushtohet rëndësi politikave social-ekonomike dhe forcimit të kontrolleve në kufi me qëllim parandalimin e këtij fenomeni.

## Moti i keq shkaktonte 27 viktima në Pakistan

**Islamabad, 11 qershor** - Shirat e dendur dhe erërat e forta lanë të vdekur të paktën 27 njerëz, përfshirë tetë fëmijë, në veriperëndim të Pakistanit, thanë zyrtarët të dielën. "Të paktën 12 njerëz humbën

jetën kur çatitë dhe muret e shtëpive të tyre u shembën", tha për AFP zëdhënësi provincial i menaxhimit të fatkeqësive, Taimur Ali Khan. Stuhitë goditën katër rrethe të provincës Cyber Pakhtunkhwa

të shtunën. Pesëmbëdhjetë njerëz vdiqën në rrethin Banu, duke përfshirë pesë vëllezër e motra nga mosha dy deri në 11 vjeç. Më shumë se 140 persona u lënduan.



# Vendoset pllakë përkujtimore në shtëpinë e Shasivar Makollit, vlerësohet lart kontributi i tij për çështjen kombëtare

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Në nderim të veprimtarisë atdhetare të Shasivar Makollit dhe familjes Makolli, në prani të shumë personaliteteve dhe qytetarëve nga të gjitha trojet shqiptare, u përvurua të shtunën pllaka përkujtimore në shtëpinë e cila ishte bazë e sigurt për veprimtarët e kohës. Në familjen e Shasivar dhe Sevdije Makollit, ku të gjithë anëtarët ishin të lidhur me kauzën kombëtare, gjetën strehim, ngrohtësi dhe mikpritje karakteristike shqiptare figura të shquara të historisë sonë moderne, duke filluar nga simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, e deri te drejtues të rëndësishëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

dhe veprimtarë të tjerë.

Në ceremoninë e organizuar nga Shoqëria Lëvizja, Ali Ahmeti ka thënë se Shasivar Makolli asnjëherë nuk iu shmangë as rrezikut dhe as veprimit për t'i realizuar qëllimet dhe idealet e kombit. "Sot përkujtojmë Shasivar Makollin, i cili asnjëherë nuk iu shmangë as rrezikut, as veprimit për t'i realizuar qëllimet dhe idealet e kombit, dhe jo vetëm, por e tërë familja Makolli, duke përfshirë këtu edhe babanë e tij, bacën Avdyll, i cili në moshë të shtyrë ishte i paepur dhe s'ka qysh dera e fisme të mos ketë atë frymëzim, i pamposhtur në të gjitha fushëbetet. Unë dua ta kujtoj këtë shtëpi, tërë këtë familje këtu, e cila ka qenë vatrë e Lëvizjes Popullore - lëvizjes së rezistencës", ka thënë Ali Ahmeti. Ndërkaq djali i veprimtarit të Adem Demaçit, Shqiptar Demaçi, ka treguar se në këtë shtëpi ka ardhur disa herë me babanë e tij. "Unë rrallë kam



Veprimtari Bardhyl Mahmuti ka thënë se familja Makolli është familja e parë pas Luftës së Dytë Botërore që i doli ballë okupatorit që kishte pushtuar Kosovën. "Jorastësisht nga kjo familje del Shasivar Makolli. Luftëtarë të shquar të çështjes

edhe pse atje ka qenë policia. Këtu kanë qenë Makollët që të kanë dhënë mbështetje", është shprehur ai. Muharrem Rama në fjalën e tij tha se Shasivar Makolli ishte vërtet trim. "Ai luftës i është bashkuar me të vetmin qëllim: ja vdekje ja liri. Lirinë e përjetuam së bashku, por vdekja e mori atëherë kur ne nuk e prisnim", ka thënë Rama. Veprimtari Shasivar Makolli ka ndërruar jetë para shtatë vjetësh.

veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli, u shndërrua në një bazë të fuqishme të rezistencës sonë kombëtare, prej kur ka filluar një numër i konsiderueshëm i aksioneve kundër okupatorëve serbë. Në familjen e Shasivar dhe Sevdije Makolli, ku të gjithë anëtarët ishin të lidhur me kauzën kombëtare, gjetën strehim, ngrohtësi dhe mikpritje karakteristike shqiptare figura të shquara të historisë sonë moderne, duke filluar nga simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, e deri te drejtues të rëndësishëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit. Prishtinë, 10 qershor 2023 Shoqëria Lëvizja".



## Në pllakën përkujtimore të vendosur në shtëpinë Makolli shkruhet:

"Në momentet më kritike të ballafaqimit të popullit shqiptar me dhunën policore dhe ushtarake serbe, shtëpia e

Zbulimin e pllakës përkujtimore e bënë lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, djali i veprimtarit të Adem Demaçit, Shqiptar Demaçi, veprimtari Bardhyl Mahmuti

ardhur me babën. E kam ndier atë energji të zemërgjerësi e të bujarisë që ka ofruar familja Makolli", ka thënë Shqiptar Demaçi.

kombëtare. Këtu ka qenë një çerdhe që çdo atdhetar i ka pasur dyert e hapura dhe askush nuk ka mundur të ndihet i rrezikuar





## Escobari bën thirrje që të dyja palët t'i kthehen zbatimit të marrëveshjes së Ohrit

I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, e ka cilësuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, partner i ShBA-së, ani pse ka thënë se ai nganjëherë është “partner i vështirë”. Ai ka përsëritur sërish se të dyja palët, Kosova dhe Serbia, duhet t'i kthehen zbatimit të marrëveshjes së Ohrit. “Ne duhet të gjejmë një mënyrë për t'i depërshkallëzuar proceset menjëherë, për ta depërshkallëzuar situatën dhe menjëherë të kthehemi në fokusin e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit”, ka theksuar Escobari. Ndërkaq kryeministri Kurti ka thënë të dielën se rruga për qetësimin e situatës në veri duhet të nisë me largimin e bandave kriminale atje

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 QERSHOR - I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, e ka cilësuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, partner i ShBA-së, ani pse ka thënë se ai nganjëherë është “partner i vështirë”. Këtë koment Escobari e ka bërë në një intervistë për Institutin për Politikë dhe Ekonomi të Evropës Juglindore me seli në Beograd të Serbisë ku, mes të tjerash, ka pohuar se Kosova mbetet partnere e rëndësishme e ShBA-së. “Zoti [Albin Kurti] është partneri ynë.

Nganjëherë është partner i vështirë, por ai është partner. Kosova është partnere. Pra, derisa ecim përpara ne duam t'i përdorim marrëdhëniet e mira që kemi me Kosovën dhe përmirësimin e marrëdhënieve që kemi me Serbinë për të gjetur një rrugë, për të gjetur një rrugë të pranueshme dhe reciprokisht të dobishme në mënyrë që të dyja [vendet] të jenë pjesë e Bashkimit Evropian”, ka deklaruar Escobari. Ai i ka bërë këto komente kur u pyet ta komentonte deklaratën e ambasadorit amerikan në Beograd, Christopher Hill, i cili këtë javë ka thënë për “Zërin e Amerikës” se Uashingtoni ka “disa

probleme shumë thelbësore” me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Hill e ka bërë këtë koment në pyetjen nëse kryeministri Kurti është i gatshëm t'i pranojë tri kërkesat e komunitetit ndërkombëtar për uljen e tensioneve në veri të Kosovës, përfshirë mbajtjen e zgjedhjeve të reja lokale në katër komunat veriore dhe rikthim në dialog. “Mendoj se kemi një problem me zotin Kurti, ai nuk është i gatshëm ta pranojë. Më duket se kemi disa probleme shumë thelbësore me të, nëse ende mund ta konsiderojmë si partner. Por, këtë vendim ia lë ambasadës sonë në

Prishtinë”, tha Hill më 8 qershor. Ndërkohë Escobari më tej tha se ShBA-ja është e angazhuar ta ndihmojë si Kosovën ashtu edhe Serbinë në integrimin e tyre në Bashkimin Evropian.

Escobari foli edhe për marrëveshjen që Kosova dhe Serbia arritën në Ohër të Maqedonisë së Veriut në muajin mars të këtij viti. Implementimi i kësaj marrëveshjeje, sipas Escobarit, i hap rrugë një “marrëdhënie paqësore dhe konstruktive” në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Ne duhet të gjejmë një mënyrë për t'i depërshkallëzuar proceset menjëherë, për ta depërshkallëzuar situatën dhe menjëherë të kthehemi në fokusin e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit”, ka theksuar Escobar. Sipas tij, për Serbinë kjo do të thoshte dhënie fund bllokimit të integritit evropian dhe ndërkombëtar të Kosovës dhe për Kosovën kjo do ta nënkuptonte fillimin e procesit të zbatimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Duhet të punojmë menjëherë për të dyja gjërat”, ka deklaruar Escobari.

Ka dy javë që janë tensionuar sërish raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Në katër komunat veriore janë duke u zhvilluar protesta nga grupe të serbëve lokalë të cilët po kundërshtojnë futjen në objektet komunale të kryetarëve të ri të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit. Më 29 maj situata u tensionua tej mase në Zveçan dhe grupe të maskuara të serbëve lënduan 30 ushtarë të KFOR-it, tre prej tyre me armë zjarri.

Kjo situatë e solli në Prishtinë sërish të dërguarin e ShBA-së, Gabriel Escobar si dhe të dërguarin e posaçëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak.

Dy zyrtarët paraqitën tri kërkesa për Qeverinë e Kosovës: qetësimin e situatës në veri të Kosovës, mbajtjen e zgjedhjeve të reja lokale në katër komunat veriore dhe rikthimin në dialogun për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi.

Pas vizitës në Prishtinë, që të dy vizituan edhe Beogradin në një përpjekje të serishme për ta qetësuar situatën.

## Kurti: Largimi i bandave është rruga drejt qetësimit në veri

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se Kosova qëndron prapa vlerave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, megjithatë ka shtuar se rruga për qetësimin e situatës në katër komunat veriore duhet të nisë me largimin, siç e ka quajtur ai, bandave kriminale atje. "Rruga përpara për qetësim dhe për normalizim nënkupton ndalimin e menjëhershëm të dhunës nga bandat kriminale para objekteve të komunës ndaj zyrtarëve të policisë, ndaj ushtarëve të NATO-s, ndaj gazetarëve dhe ndaj kryetarëve të komunave", ka deklaruar Kurti.

Kurti ka shtuar se prania e policisë në veri mund të zvogëlohet në mënyrë proporcionale vetëm nëse largohen, siç ka thënë ai, bandat kriminale nga veriu dhe arrestohen personat që shkaktuan dhunë.

Kryeministri Kurti i ka bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar të punojë në drejtim të forcimit të dialogut për zbatim të marrëveshjeve të 27 shkurtit e

arritur në Bruksel dhe asaj të 18 marsit, e dakorduar në Ohër të Maqedonisë së Veriut. "Kemi nevojë për sekuencim të balancuar dhe fer të zbatimit të marrëveshjes bazike.

Marrëveshjen jo vetëm që e kemi pranuar të dyja vendet, Kosova dhe Serbia, por ajo është edhe pjesë e konkluzioneve të Këshillit Evropian të datës 9 shkurt 2023", ka theksuar Kurti.

Duke iu referuar tensioneve në veri, Kurti tha se deri në zgjedhjet e hershme në komunat veriore, kryetarët e tanishëm duhet ta ushtrojnë detyrën e tyre, ndërsa u bëri thirrje serbëve që të marrin pjesë në zgjedhje.

Më tej, Kurti tha se objektet komunale janë në pronësi të Kosovës dhe se nuk do të lejohet që ato të shndërrohet në objekte në pronësi të një etnie të caktuar. Sa i takon dhunës së shkaktuar nga protestuesit në javët e fundit në veri, Kurti tha se ajo buron dhe urdhërohet nga Beogradi. Këto komente kryeministri Kurti i bëri të dielën në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje.

## 24-vjetori i çlirimit të Prishtinës, ushtarakët e FSK-së së bashku me fëmijët parakaluan shesheve të kryeqytetit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Në një aktivitet të përbashkët ndërmjet komunës së Prishtinës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës u shënuar të dielën 24-vjetori i çlirimit të Prishtinës.

Ushtarakët e FSK-së së bashku me fëmijët të cilët janë e tashmja dhe e ardhmja e këtij vendi parakaluan përgjatë sheshit si dy gjenerata që shënojnë tri periudha të ndryshme kohore të shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se qershori i vitit 1999 ishte muaji kur qytetet dhe zonat e Kosovës u çliruan një pas një. Ai ka thënë se përpjekjet e gjata të disa brezave ndër dekada, kulmuan me luftën e UÇK-së dhe me fushatën bombarduese të NATO-s mbi Jugosllavi, që i solli lirinë Kosovës.

"24 vjet pas çlirimit të qytetit, Prishtina sot është kryeqytet i Republikës së Kosovës, shtetit më



të ri evropian. Por, Prishtina është edhe kryeqendra jonë politike prej ku vazhdon të mirëmbahet ajo aleancë e lidhur që më 1999, mes NATO-s dhe UÇK-së, përkatësisht trashëgimtares së saj, FSK-së. E nisur si një ndihmë mes një ushtrie guerile popullore, UÇK-së dhe aleancës më të fuqishme ushtarake në botë, NATO-s, ndër vite ajo ka marrë trajtën e një raporti të mirëfilltë mes aleatësh ushtarakë dhe partnerësh

strategjikë", ka thënë Mehaj. Ai ka theksuar se Forca e Sigurisë së Kosovës si zgjatim i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, asaj ushtrie që e bëri NATO-n të futej në luftë për lirinë e Kosovës, po zhvillohet me trajnime ushtarake, kapacitete luftarake dhe aftësi ndërveprueshmërie sipas standardeve më të larta të NATO-s, veçanërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aleatit tonë kyç dhe jetik.



## Ministri Krasniqi dhe kryetari i Shtimes vizituan ish-krerët e UÇK-së

Hagë, 11 qershor - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi dhe kryetari i Shtimes, Qemajl Aliu, i kanë vizituar ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë, ka njoftuar kryetari i Shtimes, i cili u shpreh se ish-krerët e UÇK-së vullnetin dhe moralin e kanë të lartë. "Vullnetin e moralin e kanë të lartë, siç e kanë pasur besimin për fitore kur e kanë filluar luftën. Andaj, edhe rezultati përsëri do të jetë në favor të historisë sonë të lavdishme

kombëtare e çlirimtare", ka shkruar Aliu në "Facebook". Krerët e UÇK-së po akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998/99. Ata ndodhen në qendrën e paraburgimit në Hagë prej nëntorit të vitit 2020. Aktakuza ndaj tyre ishte konfirmuar në nëntor të vitit 2020 për t'u ndryshuar pastaj më 3 shtator 2021, 29 prill dhe 30 shtator 2022.

Ata janë shprehur të pafajshëm nga të gjitha akuzat.



## Policia konfiskon pajisje për prodhim të kriptovalutave në Zubin Potok

ZUBIN POTOK, 11 QERSHOR - Policia e Kosovës ka njoftuar se ka konfiskuar 11 pajisje për prodhim të kriptovalutave në fshatin Uglar të Zubin Potokut. Në njoftimin e Policisë së Kosovës thuhet se qytetarët e lagjes ku kanë qenë të instaluar pajisjet për prodhim të kriptovalutave e kanë raportuar rastin në polici pasi, siç thuhet, ata kanë pasur probleme të vazhdueshme me energji elektrike që si pasojë ka dëmtuar pajisjet shtëpiake. "Policia e Kosovës bazuar në detyrat dhe autorizimet ligjore kanë ndërmarr veprime të

menjëhershëm dhe ka identifikuar lokacionin [shtëpinë] e personit të dyshuar dhe në shtëpi janë gjetur njëmbëdhjetë pajisje për prodhimin e kriptovalutave [Bitcoin]", thuhet në njoftimin e policisë.

Policia thotë se nuk ka gjetur në shtëpi personin e kërkuar meqë "i dyshuari nuk gjendej në shtëpi pasi që herë pas here udhëton nga Beogradi i Serbisë dhe viziton shtëpinë lartcekur [në Zubin Potok]".

Që nga viti i kaluar Policia e Kosovës ka zhvilluar dhjetëra aksione për konfiskimin e

pajisjeve për prodhimin e kriptovalutave. Në katër komunat veriore, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, janë konfiskuar qindra pajisje dhe në të kaluarën janë identifikuar 'ferma' për prodhim të kriptovalutave.

Prodhimi i kriptovalutave është i ndaluar në Kosovë që nga shfaqja e krizës energjetike vitin e kaluar. Prodhimi i kriptovalutave në vitet e fundit ka qenë i koncentruar në katër komunat veriore pasi që atje qytetarët nuk e paguajnë energjinë elektrike që nga viti 1999.



## Ministri Çeku: Serbia po shfaq mosdurim nacional në Luginë të Preshevës



PRISHTINË, 11 QERSHOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit i Kosovës, Hajrulla Çeku, e ka akuzuar shtetin e Serbisë që, sipas tij, ka shfaqur 'mosdurim nacional', kur më 9 qershor institucionet serbe ndaluan shfaqjen e dy filmave shqiptarë të financuar nga Qeveria e Kosovës.

Ministri Çeku tha se veprimi i autoriteteve serbe për ta ndaluar shfaqjen është i "paprecedent dhe i papranueshëm". "Një ditë para shfaqjes së filmave, policia e Serbisë i merr në bisedë

informative drejtorin e Shtëpisë së Kulturës në Bujanoc, producentin dhe aktorët e filmave. Pa asnjë motiv konkret, e madje duke e paragjykuar përmbajtjen e filmave, autoritetet serbe ndalojnë shfaqjen e filmave deri në një vendim të radhës", ka shkruar ministri Çeku, duke shtuar se "ky akt më e pakta që mund të emërohet, është mosdurim nacional".

Çeku me tej ka thënë se është gabim të mendohet se Serbia ka ndryshuar pasi, siç ka shkruar ai,

ndalimi i shfaqjes së filmave është bërë vetëm pse aktorët janë shqiptarë dhe filmi është mbështetur financiarisht nga Qeveria e Kosovës.

Më 9 qershor Policia e Serbisë në Bujanoc ka shoqëruar në stacion policor drejtorin e Shtëpisë së Kulturës, Jetmir Ismaili, si dhe ka intervistuar aktorin Gani Veseli. Me vendim të autoriteteve serbe filmat nuk do të mund të shfaqen deri në përfundim të hetimeve. Në Luginë të Preshevës ka pasur reagime të shumta pas ndalimit të shfaqjes së këtyre dy filmave.

## Dita e Çlirimit të Prishtinës, Rama bën homazhe te Varrezat e Dëshmorëve

Prishtinë, 11 qershor - Në 24-vjetorin e çlirimit të Prishtinës, kreu i saj, Përparim Rama, ka bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve. Rama e ka vlerësuar këtë ditë si më të rëndësishmen për gjithë vendin e veçmas për kryeqytetin. "Me nderim dhe mirënjohje të thellë, sot përulemi para atyre që rezistuan dhe luftuan për lirinë e Prishtinës. U bëjmë homazhë dëshmorëve të rënë dhe i drejtojmë lutjet tona për familjet e tyre, sepse janë ato që mbajnë barrën e sakrificës dhe na frymëzojnë me



përkushtimin e palëkundshëm ndaj çështjes sonë fisnike. Lavdi dhe nder i përjetshëm dëshmorëve, heronjve të

vërtetë të atdheut tonë", ka thënë Rama derisa ka bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve.

## Në 24-vjetorin e çlirimit, Rama i jep titullin "Qytetar Nderi i Prishtinës" lordit britanik Paddy Ashdown

Komuna e Prishtinës, me rastin e 24-vjetorit të çlirimit të kryeqytetit, i ka dhënë titullin "Qytetar Nderi i Prishtinës" lordit britanik Paddy Ashdown, për kontributin e tij në luftën për drejtësi dhe pavarësinë e Kosovës. "Paddy Ashdown ishte udhëheqës, diplomat dhe luftëtar i drejtësisë, i cili ndikoi thellë në peizazhin politik në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Kosovë. Ai kundërshtoi veprat mizore dhe përkrahu pavarësinë e Kosovës që në vitin 1996. Duke dëshmuar në gjykatën ndërkombëtare të Hagës dhe mbështetur intervencionet e NATO-s, ai u bë zëri i drejtësisë për Kosovën", ka thënë Rama.



## Komuna e Drenasit vlerësohet si storie suksesi nga Zyra e BE-së për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë

DRENAS, 11 QERSHOR - Komuna e Drenasit vlerësohet si storie suksesi nga Zyra e BE-së për implementimin e projektit "Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë". Në kuadër të projektit KosEd, i financuar nga BE-ja, është mbajtur simpoziumi i drejtorive komunale të

arsimit i të gjitha komunave të Kosovës.

Në këtë simpozium Drenasi është rekomanduar si model që duhet ndjekur nga komunat e tjera në implementimin e projektit "Përkrahje për arsimin fillor dhe të mesëm të lartë". Kjo u konkludua nga eksperti i

Zyrës së BE-së për mbështetje të arsimit para universitar, Robert Blease.

Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria për Arsim, mbetet e përkushtuar t'i implementojë projektet të cilat kontribuojnë për rritjen e cilësisë në arsim, që ndikon drejtpërdrejt te nxënësit tanë.



# Zvarritet miratimi i pagës minimale, s'dihet a do të procedohet në Kuvend apo mund të tërhiqet nga Qeveria e Kosovës

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Paga minimale vazhdon të mbetet ende 130 euro dhe 170 euro. Përkundër premtimit të Qeverisë së Kosovës për rritje të pagës minimale, ky projektligj po vazhdon të zvarritet që një vit nga pushteti, vlerësojnë deputetët opozitarë.

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon që paga minimale të kthehet prapa me arsyetimin se është jashtë kontekstit ekonomik e social në vend, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konsideron se qeveria po dështon t'i miratojë ligjet që nuk i konvenojnë.

Projektligji për Pagën Minimale në lexim të dytë ka kaluar në Komisionin për Buxhet javën që shkoi, mirëpo pushteti ende ka mëdyshje nëse do të procedohet si i tillë në Kuvend apo mund të tërhiqet nga Qeveria e Kosovës. Ndërkaq, njohësit e ekonomisë konsiderojnë se është e rëndësishme mënyra se si vjen te paga minimale. Sipas tyre, duhet të shikohet mundësia për rritjen të shumës nga ajo që është prezantuar.

Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka deklaruar se ky projektligj në lexim të dytë ka kaluar në Komisionin për Buxhet

javën që shkoi, mirëpo ka theksuar se mbetet me një vendim të qeverisë se a do të procedohet si i tillë në Kuvend apo mund të tërhiqet nga qeveria. "Projektligji për Pagën Minimale në lexim të dytë ka kaluar në Komisionin për Buxhet javën që shkoi dhe, po ashtu, amendamentet, të cilat gati se e bëjnë të pazbatueshëm ligjin për shkak të normës dhe të pagës minimale edhe të disa provizioneve të tjera, të cilat kanë kaluar atë ditë. Mbetet tash me një vendim të qeverisë se a do të procedohet si i tillë Projektligji në seancë apo mund të tërhiqet nga Qeveria e Kosovës", ka theksuar Kusari-Lila.

Se Ligji duhet të tërhiqet prapa e thotë edhe deputeti nga LDK-ja, Avdullah Hoti. Sipas tij, projektligji është diskutuar më shumë se një vit përpara se të hyjë në krizën e rritjes së çmimeve, me ç'rast thotë se edhe paga minimale që kanë propozuar është jashtë kontekstit ekonomik dhe social në vend.

Hoti kërkon që në diskutim duhet të përfshihen të gjitha kategoritë që marrin pensionet e tyre dhe që lidhen me pagën minimale.

Ndërkaq, deputeti nga radhët e AAK-së, Pal Lekaj, thotë se kjo qeveri ka dështuar sa i përket miratimit të ligjeve. Sipas tij,



qeveria e ka humbur arsyen për të qenë në qeverisje dhe sa më e parë që shkon aq më mirë është për qytetarët e Kosovës. "Sa i përket Ligjit për Pagën Minimale edhe në aspektet e tjera kjo qeveri ka dështuar dhe atëherë kur nuk i bie tamam edhe i prolongon ligjet. Është për të ardhur keq që ka kaluar në Komisionin për Buxhet dhe nuk procedohet në Kuvend", ka theksuar Lekaj.

Ndërsa njohësit e ekonomisë i bëjnë thirrje qeverisë që t'i bëjnë të gjithë parametrat e nevojshëm për pagën minimale. Sipas tyre, krahasim me krizën e inflacionit

në vend, paga e propozuar nuk është e mjaftueshme.

Njohësi i ekonomisë, Besnik Avdiaj, thotë se për punëtorët edhe 250 euro sot nuk është e mjaftueshme nëse merret parasysh rritja e çmimeve dhe kostot e jetesës në vend. "Përcaktimi i pagës minimale në një vend është një kriter i cili e ndihmon rritjen e dinjitetit të punëtorëve. Shumë e rëndësishme është mënyra se si vjen te paga minimale, nëse ata i kanë të gjithë parametrat dhe i kanë bërë të gjitha matjet e nevojshme për ta parë efektin e pagës minimale në

ekonomi. Për punëtorët edhe 250 euro sot nuk është e mjaftueshme nëse marrim parasysh rritjen e çmimeve dhe kostot e jetesës në vend", shprehet Avdiaj.

Se Ligji i Pagës Minimale duhet të rritet e thotë edhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna.

Kuvendi i Kosovës më 14 qershor të vitit të kaluar ka votuar në parim Projektligjin i cili hap rrugë për rritjen e pagës minimale. Projektligji i miratuar parasheh rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto apo 250 euro neto, nga 130-170 sa është aktualisht.

## Kompani ndërkombëtare të interesuara për ankandin e parë solar në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Disa kompani, përfshirë edhe ato ndërkombëtare, kanë shprehur interesim për ankandin e parë solar të Republikës së Kosovës prej 100MW. Kështu ka bërë me dije

ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, e cila së bashku me kryetarin e Rahovecit, Smajl Latifi, kolegët nga USAID Kosovo dhe disa nga investitorët potencialë, janë mirëpritur nga banorët e zonës në tokën e ankandit të parë solar fotovoltaik të Republikës së Kosovës prej 100MW, te Guri i Kuq

dhe Kramoviku i Rahovecit. Sipas saj, banorët ishin entuziastë për investimin që po vjen dhe të lumtur që kjo tokë jobujqësore që me vite nuk ka qenë në shfrytëzim, tani do të shfrytëzohet për të prodhuar energji elektrike të pastër. "Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që,

në bashkëpunim me USAID-in, të udhëheqë një proces konkurrues fer e transparent. Deri tani kemi pasur numër të madh të kompanive të interesuara, përfshirë kompani ndërkombëtare me përvojë e reputacion të lartë", ka thënë Rizvanolli.

Në fund ajo i ka ftuar të gjitha kompanitë kosovare e ndërkombëtare, dhe mërgatën tonë, që ta shqyrtojnë dokumentacionin e aplikimit, ta ndajnë me investitorët potencialë dhe t'i dërgojnë pyetjet eventuale përmes kanaleve zyrtare sipas udhëzimeve.

# Kosova dhe NATO, bashkëluftëtarë në rrugën e bërjes së kombit shqiptar



Prof. dr. Kudusi LAMA, gjeneral në pension

- Fjalë rasti në përvjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1878 dhe të çlirimit të Kosovës më 1999, mbajtur në Vjenë më 9 qershor 2023

Mirëmbërma të gjithëve, Është privilegj për mua, të jem këtu në mesin tuaj dhe të marr fjalën në këtë veprimtari festive dhe përkujtimore në nderim të përbërësve të historisë dhe të lavdisë së kombit shqiptar.

Duket sikur datat historike të kombit tonë mbështeten në gjoksin e njëra-tjetrës.

Ashtu edhe 10 e 12 qershori duket sikur i japin forcë njëra tjetrës e na ftojnë të hedhim shikimin mbi ato faqe të historisë kombëtare që kanë përcaktuar kahun e ecjes së kombit tonë nëpër kohë.

10 qershori do të mbahet mend historikisht si dita kur burrat shqiptar, u mblodhën në Prizren për ta bërë Shqipërinë, duke dalë përballë gjithë politikës dhe fuqisë së madhe të botës, për të mos lejuar të zhduket kombi ynë e historia e tij e lavdishme.

Ndërsa 12 qershori vjen me çlirimin e Kosovës, një treve shqiptare të mbajtura për një shekull nën pushtimin sllav. E kjo ditë erdhi pas një lufte të madhe të shqiptarëve për ta fituar lirinë, të organizuar e rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ushtri e cila me luftën e saj, arriti të marrë me vete si bashkëluftëtarë gjithë botën moderne dhe NATO-n - forcën më të madhe politike e ushtarake të kohës.

Dhe të marrësh me vete NATO-n si bashkëluftëtarë për të çliruar atdheun tënd dhe popullin tënd nga pushtimi, kjo në atë kohë për shumë nga aktorët konsiderohej e pa mundur qoftë edhe nga fuqi me zë, jo më nga një ushtri, që deri dje në radhë të parë në Tiranë e në Prishtinë, e quanin një organizatë e panjohur, një grup njerëzish të paditur, njerëz të pa shkolluar, njerëz që nuk ishin gjë tjetër veçse dorë e zgjatur e Serbisë, që ishin me ide komuniste e do të krijonin një Kubë në Ballkan, që ishin me

pikëpamje islamike, që ishin terroristë, që ishin të pa përgjegjshëm etj. Por burrat dhe gratë e Kosovës të cilët kishin marrë përgjegjësitë të luftonin për çlirim dhe që kishin një vizion të qartë, nuk u ligështuan nga këto etiketime. Ata vijuan luftën dhe arritën fitoren duke u bërë Kosova dhe NATO-ja bashkëluftëtarë në rrugën e bërjes së kombit shqiptarë. Në atë rrugë që ishte filluar në atë Prizren më 10 qershor të vitit 1878. U bënë pra pjesë të një veprë të madhe njerëzore forcat më të përparura e moderne të kohës, por ishin njerëzit tanë të vendosur, prandaj erdhën edhe ata. Këtë nuk duhet ta harrojmë kurrë.

Operacioni i pa imagjinueshëm i Jugosllavisë dhe Serbisë kundër Prekazit dhe qëndresa e pashembullt e Jasharëve, që hodhi bazat e masivizimit të shpejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është një faqe historie e pa përsëritshme. Në atë operacion morën pjesë 8 mijë trupa ushtarake dhe policore të pushtuesit. Të cilët krijuan dy rrethime. Një rrethim të brendshëm me 4 mijë forca dhe një rrethim të jashtëm me 4 mijë forca të tjera. Rrethimi i jashtëm kishte për qëllim të mos lejonte që formacione të UÇK-së të mund të depërtonin në Prekaz. Kurse rrethimi i brendshëm do të luftonte kundër forcave të rrethuara brenda në Prekaz.

## Po sa forca ishin të rrethuar në Prekaz?

Jo më shumë se 60 veta, të të gjitha moshave, burra e gra, djem e vajza dhe fëmijë. 60 përballë 4 mijë, raporti është 67 ushtar e polic të pushtuesit, përballë një luftëtarë të UÇK-së pavarësisht ishte luftëtar, ishte plak a fëmijë. Dhe ky operacion zgjati 3 ditë. Është operacioni me raportin më të jashtëzakonshëm në historinë botërore, nuk njihet një tjetër i tillë.

Për 3 ditë kanë rënë perandori. E 3 ditë bëri rezistencë Prekazi, luftuan Jasharët, bënë historinë e qëndresës si askush tjetër. Adem Jashari bëri epokën e tij. Jasharët bënë që shqiptarët t'i thërrasin mendjes e të vrapojnë të kapin pushkën, të rreshtohen në radhët e UÇK-së, e cila kishte marrë e ngritur lartë flamurin e luftës për liri.

U bë luftë e përgjakshme, u bënë qëndresa të mahnitshme. U masivizua ushtria më e disiplinuar në botë. Ajo ushtri që e kishte shumë të qartë rrugën nga po shkonte dhe detyrat që kishte mbi vete për t'i kryer.

Me luftën e saj, me qëndresën, me sakrificën, UÇK-ja u bë qytetare e botës moderne. Nuk e

deshi bota, nuk u dashurua bota pas UÇK-së, por ajo i mbylli të gjitha rrugët e shmangies dhe të akuzës, për veprën e saj. U bënë edhe përpjekje për ta akuzuar ndërkombëtarisht, por mençuria e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, mençuria e të gjithë hierarkisë së komandantëve dhe të gjithë luftëtarëve, bëri që bota të kuptojë se vija politike e ndjekur prej saj deri në atë kohë ishte e gabuar. Prandaj edhe u kthye, njohu drejtësinë e Luftës Çlirimtare të Kosovës, njohu sakrificat, njohu vizionin dhe synimet e UÇK-së. U pajtua dhe i pranoi ato. Dhe mori armët e erdhi në luftë bashkë me UÇK-në për të çliruar përfundimisht Kosovën nga pushtimi njëshekullor serb.

I jemi mirënjohës ShBA-së, BE-së dhe NATO-s për atë veprë njerëzore, logjike dhe qytetare që bënë duke u bërë bashkëluftëtarët tanë për liri.

Ju kujtoj se qëndrestari i kombit shqiptar Adem Demaçi ka thënë: "Unë e dua veten, i dua edhe të tjerët, prandaj edhe të tjerët më duan mua; Unë e nderoj veten, i nderoj edhe të tjerët, prandaj edhe të tjerët më nderojnë mua; Unë i besoj vetes, u besoj edhe të tjerëve, prandaj edhe të tjerët më besojnë mua". Kurrë të mos e harrojmë këtë thënie të madhe, sepse pa këtë parim nuk kemi e nuk do të kemi kurrë personalitet.

E citova këtë thënie të Demaçit të madh, sepse duhet të bëhen vlerësime të sakta e të dinjitetshme kur është fjala për vetveten. Nuk është normale, të arrihet sot deri në ato nivele, që të përkujtojmë thjeshtë masakrat që kanë bërë serbët nëpër fshatrat shqiptare, por të mos përkujtojmë operacionet fitimtare të UÇK-së; është e pa pranueshme të përkujtojmë shpërnguljen e qytetarëve të Kosovës nën presionin masakrues të pushtuesit, e të mos përkujtojmë aktet vetëmohuese të njësive të UÇK-së përballë forcave të pushtuesit. Ne duhet të kemi të qartë se Jugosllavia e kohës dhe Serbia në vitet e Luftës Çlirimtare në Kosovë sollën mbi 70 mijë trupa ushtarake; 12 deri 20 mijë trupa policore; 8 mijë trupa paramilitare, 5 mijë trupa vullnetare e kriminale të liruara edhe nga burgjet, si dhe 63 mijë trupa territoriale të armatosur me të gjitha armët të organizuara me serbët qytetarë të Kosovës. Kjo trupë në total arrin në 158 deri në 166 mijë trupa të armatosura luftarake përballë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nëse nuk e kemi parasysh këtë ballafaqim mund të flasim si të duam. Mund të themi që ishim çliruar edhe me nja 10 mijë a 20

mijë mercenarë, siç edhe është thënë me papërgjegjshmëri.

Prandaj duhet të festojmë se kemi të drejtë të festojmë, duhet të përkujtojmë se kemi çfarë përkujtojmë, por edhe duhet të mbajmë në vëmendje, se edhe sot, 24 vjet pas çlirimit, Kosova është i vetmi shtet në botë që nuk ka obelisk të lirisë. Gjithë shtetet e botës kur vijnë delegacione për vizitë dërgohen për të bërë homazhe e vendosur një kurorë me lule tek obelisku i lirisë. Ndërsa ne ku t'i dërgojmë të bëjnë homazhe? Sepse akoma nuk kemi vendosur përfundimisht kujt të ia japim primatin e sjellësit të lirisë. A thua se liria ishte një kuletë pushteti. Jo, të dashur bashkëkombës, liria është shenjtëri dhe kush sjellë lirinë është i shenjtë. E këtë liri që e gëzojmë sot, na e solli Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Këtu ju lus të mos bëni lëshime se kush bën lëshime gabon. NATO-ja ishte në luftë bashkë me ne në Kosovë. Ajo ishte forca ajrore e një force tokësore që quhej Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Këtë siç thotë shqiptari i moçëm nuk e luan as topi, kush nuk është i kthjelltë bën mirë të kthjellohet. Presidenti i ShBA-së, Bill Clinton, që në vizitën e tij të parë në Kosovë ka thënë: "Kosova meriton të jetë në Unionin Evropian, në NATO si vend i pavarur". Por ne nuk harrojmë kurrë as faktin që mbështetja e ShBA-së ka qenë jetike për lirinë tonë e do të jetë edhe për të ardhmen e historisë së sukseseve të Kosovës.

Por Kosova dhe gjithë shqiptarët nuk mund dhe nuk duhet të harrojnë se kemi ardhur nëpërmjet një politikë aparteidi që pushtuesi kishte instaluar në jetën dhe të ardhmen tonë, me qëllim ndryshimin përfundimtar të përbërjes etnike të trojeve të pushtuara.

A mund të pretendojë Bashkësia Ndërkombëtare se bëri diçka për t'i shpëtuar shqiptarët para vitit 1999? Ju them unë, siç thonë edhe analistët e saj, se ajo dështoi plotësisht, duke e quajtur të paqenë çështjen e shqiptarëve nën Jugosllavi. As lëvizjes së rezistencës paqësore, që u krijua pas vitit 1990 në Kosovë, nuk iu ofrua mbështetje e nevojshme. Vendimi për ta përjashtuar çështjen e Kosovës nga negociatat e Dejtonit, si dhe mungesa e rezultateve nga strategjia paqësore, bëri që shumë shqiptarë të Kosovës të vijnë në përfundimin që lufta e armatosur ishte mënyra e vetme për ta tërhequr vëmendjen ndërkombëtare. Dhe është pikërisht kjo koha kur në skenë doli UÇK-ja.

Ndërsa fuqitë ushtarake, policore, paramilitare, kriminale e territoriale jugosllave e serbe

megjithëse superiorë në forca, në mjete, armë e municione, duke mos mundur të qëndrojnë përballë forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, gjithë mizorinë e tyre e drejtonin kundër qytetarëve të pa armatosur shqiptarë duke i përndjekur e masakruar nëpër shtëpitë e tyre, duke e kthyer synimin e tyre në një luftë për pastrim etnik të shqiptarëve nga trojet e tyre. Gjatë vitit 1998 me shumë se 400.000 njerëz u dëbuan nga shtëpitë e tyre.

Ndërsa në periudhën nga 24 marsi e deri më 19 qershor të vitit 1999, u vranë mbi 14 mijë civilë, sipas vlerësimeve ndërkombëtare, të gjithë shqiptarë të Kosovës të vrarë nga forcat e Republikës Federative të Jugosllavisë. Rreth 900.000 civilë u detyruan në mënyrë të dhunshme lënë Kosovën, ndërkaq 590.000 të tjerë ishin të zhvendosur përbrenda Kosovës. Prej nga shihet se shpërngulja shkon në 75 për qind të shqiptarëve, me synimin për ta ndryshuar plotësisht raportin demografik të Kosovës në interes të Serbisë.

NATO-ja duke ardhur në Kosovë, për t'u bërë forcë ajrore e UÇK-së për çlirim, bëri veprimin më legjitim, pasi vlerësohet se ndërhyrja ishte e justifikueshme, meqë ishin shpenzuar që të gjitha mundësitë diplomatike. NATO-ja pra, i dërgoi për herë të parë forcat e armatosura në një luftë. E me këtë përjetësoj ekzistencën e saj, pasi mësoj se si mund të jetë e nevojshme dhe e efektshme në jetën e shoqërisë njerëzore pas fshirjes së blloqeve kundërshtarë.

Ashtu sikurse nuk duhet harruar, se ishin shqiptarët në diasporë ata që u bënë pjesa më radikale e komunitetit shqiptar të Kosovës, dhe se ishin ata të cilët kanë rol të madh në krijimin dhe fuqizimin e UÇK-së. Dhe kjo sepse diaspora u bë strehë e të gjithë atyre që organizoheshin për të vijuar luftën dhe u bë njëkohësisht burim furnizimi për këtë ushtri dhe luftën e saj. Sepse, sa herë goditeshin organizimet e brendshme, merrnin fuqinë organizimet jashtë. Siç ka ndodhur në mjaft periudha me Lëvizjen Popullore të Kosovës, e cila ishte djepi që përkundi UÇK-në, që e ushqeu dhe e rriti për ta bërë trimëshën më të madhe të të gjitha kohërave. Në atë djep u përkund edhe Ushtria Çlirimtare Presheve – Medvegje – Bujanoc, ashtu edhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare, nëpërmjet të cilave u arrit që shqiptarët të kenë prej këtej kahun e rritjes dhe fuqizimit, si dhe të bëhen miq me popujt e shtetet më të zhvilluara e më demokratike të botës, siç janë ShBA-ja dhe



Bashkimi Evropian.

Duhet kuptuar se UÇK-ja ishte një ushtri, e cila u ngrit në një terren të pushtuar, me trupa të pa stërvitura ushtarakisht, me armë e municione të transportuara nëpër male me krah. Dhe kjo ushtri pati guximin të vihej përballë fuqisë ushtarake e policore të Jugosllavisë dhe të Serbisë, që përveç forcave të afta profesionalisht e të provuara nëpër luftëra në Kroaci e në Bosnje, kishte armatim e municion pa kufizim, kishte tanke e avionë, topa e autobllinda dhe të gjitha i prodhonte vetë në industrinë e saj ushtarake. Dhe kjo pasqyrë ishte kur diplomacia ndërkombëtare hidhte ide për të vendosur embargo kundër Jugosllavisë dhe UÇK-së. Kuptoni se për kë mendohej e planëzohej kjo embargo, kur forca e fuqishme – Jugosllavia e Serbia i prodhonte vetë armët e UÇK-ja i sillte me krah me sakrificë duke i transportuar nëpër gjithë vendet e botës për t'i sjellë në frontin e luftës.

Dhe shkohej deri atje, sa të kërkohej llogari e të bëhej presion, përse stërviten, organizohen e armatosen luftëtarët e UÇK-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ku duhet të shkonin ata trupa përveç se në ato hapësira të Shqipërisë pranë kufirit me Kosovën?

Në atë kohë Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së vlerësonte, se: Sulmet e fundit nga ana e njësiteve paraushtarake të shqiptarëve të Kosovës (kupto UÇK – KL) e dëshmuar gatishmërinë, aftësinë dhe synimin për të përfutur nga tërheqja e pjesëve e policisë dhe e formacioneve ushtarake. Njoftimet për armë të reja, municion dhe pajisje, e tregojnë se aftësia e këtyre njësiteve për ta mbrojtur vetveten është ende mjaft e lartë. “Këto janë zhvillime shqetësuese”. Pra, unë personalisht nuk kam si të kem nderim për OKB-në, që dëshironte asgjësimin e UÇK-së dhe konsideronte shqetësim fuqizimin e saj, vetëm pse nuk dëshironin të pranonin se lufta e UÇK-së tashmë ishte kthyer në një luftë të përgjithshme qytetare të shqiptarëve, e paracaktuar që të

vazhdonte edhe më tutje, dhe madje edhe që të intensifikohej edhe me tepër, nëse nuk do të merrte përmasat e mëdha të luftës ndërkombëtare me bërjen e NATO-s forcë ajrore e UÇK-së.

Fushata ajrore e NATO-s kundër Jugosllavisë u zhvillua nga 24 marsi 1999 deri më 10 qershor 1999. Gjatë kësaj fushate aeroplanët nga 13 shtete anëtare të NATO-s, bënë 38.400 fluturime. Në këtë fushatë, ShBA-ja bën mbi 60% të numrit të tërësishëm të fluturimeve dhe mbi 80% të numrit të tërësishëm të goditjeve. ShBA-ja, po ashtu, e kishte rolin dominues në realizimin e aspekteve më moderne të fushatës ajrore, deri në përfundimin e luftës.

Por njëkohësisht është pranuar nga komisionet ndërkombëtare të vlerësimit të asaj kohe, se sidoqoftë, ishte strategjia “ndërkombëtarizuese” e UÇK-së ajo e cila e nxiti ndërhyrjen ushtarake të udhëhequr nga NATO-ja, dhe jo kompromisi diplomatik, dhe kjo strategji çonte me gjasë më të madhe drejt pavarësisë e jo kah ndonjë autonomi e tipit të para 1989-s, siç pretendohet.

Ashtu sikurse Këshilli i Sigurimit i OKB-së nuk i kushtoi vëmendje nevojshme çështjes së Kosovës deri në vitin 1998, kur tashmë kishte ardhur deri te përsheptimi në shkallëzimin e luftës së armatosur të UÇK-së. E ç'është më e rëndësishmja, me rezolutë kërkonte të vihej embargo në armatim për RFJ-në dhe për UÇK-në, si dhe të “parandalohet armatosja dhe trajnimi i aktiviteteve terroriste” nga të gjitha shtetet. Qëndrime që nuk e nderojnë OKB-në.

OKB-ja nuk i dha përkrahje UÇK-së si lëvizje çlirimtare, dhe as kërkesës së gjerë për pavarësi të Kosovës, por kjo, po ashtu, nuk e ndërmori asnjë hap për ta penguar përkrahjen ndërkombëtare për kryengritje dhe këtë le ta quajmë një veprim të mbarë pavarësisht se ishte thjeshtë pamundësi e saj për të vepruar ndryshe.

Në vlerësimin e Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe UÇK-së, mund të them se vetëm ShBA-ja nuk gaboi, megjithëse edhe ajo e korrigjoi veprimtarinë me

vonesë. Ajo fillimisht e shikoi UÇK-në si një trajtë të trysnisë e cila do ta detyronte Millosheviqin për ta arritur ndonjë zgjidhje sepse, në të kundërtën, do të duhej të ballafaqohej me një sfidë edhe më të fuqishme të kryengritjes kundër sovranitetit të Jugosllavisë.

Megjithatë, Perëndimi prej janarit të vitit 1998 deri në shkurt të vitit 1999, nëntë herë i dha leje Millosheviqit të vendosë qetësi në Kosovë. Pra të mos kishte më krizma armësh. Në të njëjtën kohë, duket qartë që Millosheviqi bëri llogari të gabuara, duke u besuar efekteve të fushatës serbe kundër UÇK-së në muajt e saj të parë, gjë që e bëri të supozonte që kërcënimi nga UÇK-ja ishte mënjanoar. Ky është një nga ai lloj i gabimeve që janë karakteristike për luftërat kundër kryengritjeve: pasiviteti i sfidës kryengritëse interpretohet si mposhtje e saj, dhe, më pastaj, shfaqja sërish e rezistencës së armatosur dukej si një befasi e papritur. Por kjo ndodhte sepse shqiptarët përfundimisht kishin vendosur të jetonin të lirë.

Kosova erdhi nga lufta tërësisht e shkatërruar. Pamja e ditëve të para të qershorit 1999, ishte me rrugë të zbrazëta, dyqane të shkatërruara, ujësjellës të shkatërruar, papunësi e plotë, gërmadha dhe tym, të vrarë në rrugë, kufoma dhe grumbuj plehrash, pa bukë, pa mjete informimi, pa shkollë, tokat të pasigurta për t'u punuar nga minimet pa kriter të forcave jugosllave, shumica e bagëtive të humbur, mbi 120.000 shtëpi të djegur e të shkatërruara, rreth 300 objekte shkollore të shkatërruara ose djegur, sistemi i kujdesit shëndetësor si dhe sistemi bankar ishin shkatërruar; rrugët të prishura; nuk kishte rrymë elektrike; nuk kishte shërbime postare, ndërkaq linjat telefonike ishin të rrëzuara etj.

Prandaj edhe në atë kohë, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së doli me deklaratën në të cilën thuhej se “UÇK-ja do ta dënonte secilin që do ta merrte guximin të nënshkruante ndonjë marrëveshje e cila do të ofronte

më pak se vendimi i popullit të Kosovës i shprehur me Referendumin e vitit 1991,” domethënë nga pavarësia. Dhe UÇK-ja e mbajti fjalën e solli lirinë dhe e krijoi shtetin.

### Por, ku jemi sot? Çfarë po bëjmë?

Duket se në perëndim ka shumë simpatizantë të Rusisë dhe Serbisë.

Dhe nuk më vjen keq pse ka. Por më vjen keq që vlerësohen kundërvlerat.

Sot ne kemi në një gjyq fashist kërret e UÇK-së dhe të shtetit të Kosovës. Dhe për çfarë arsyeje? Vetëm se kanë bërë një vepër kombëtare. Vetëm pse kanë kryer me nder detyrën ndaj atdheut e popullit të tyre. Vetëm pse kanë luftuar me armë në dorë pushtuesin që për një shekull kishte masakruar shqiptarët.

Sot po kërkohet që shqiptarët në Kosovë të jenë tolerantë. Dakord. Toleranca është kusht për lirinë. Por tolerancë nuk donë të thotë harresë, dhe toleranca nuk është zëvendësim për drejtësinë. Ata të cilët kanë kryer krime dhe vijojnë të kryejnë krime në Kosovë duhet të dënohen.

Por sot po kërkohet të lihen serbët të bëjnë si të duan, të lihen të mos zbatojnë ligjet e shtetit, të mos paguajnë taksat e shtetit, të mos kryejnë detyrimet si shtetas, vetëm se qenkan serbë. Dhe këto i kërkon demokracia perëndimore. Thuhet se i kërkon edhe Amerika, por unë nuk e besoj, sepse Amerika është fanatike në zbatimin e ligjeve.

Unë e kuptoj tolerancën. Dhe tolerancë do të thotë gatishmëri për të jetuar pranë e pranë me armiqtë e deridjeshëm dhe për të bashkëpunuar me ta politikisht, në mënyrë që të mos lejohet ripërtëritja e dhunës. Por Serbia dhe serbët nuk ndalen. Ata nuk duan bashkëjetesë, por mbisundim. E mbisundimi kurrë nuk do të vijë më për ta. Bëjnë mirë të ndërgegjësohen.

Ne jemi të qartë, se meqenëse Bashkësia Ndërkombëtare na ndihmoi të çlirohemi, i ka dhënë vetes edhe të drejtën për të ngulmuar që Kosova e pavarur

duhet t'u japë të drejta të barabarta të gjithë qytetarëve të cilët janë të vendosur që të jetojnë në të. Por a po e bën këtë? A po kërkon të drejtë të barabartë për të gjithë, apo po na fut në rrugë qorre e pa të ardhme, duke tentuar të na krijojë një mjedis të mjegullt për të ardhmen. Duket sikur sot po mendohet se mund të kthehet koha e Millosheviqit. E ajo kohë ka vdekur. Të vdekurit nuk kthehen.

Popullata pakicë në Kosovë duhet të pajtohet me faktin që shpresa e tyre më e mirë për një të ardhme afatgjatë në Kosovë qëndron në pjesëmarrjen e plotë në institucionet e shtetit dhe në bindjen para ligjeve.

Ashtu sikurse të gjithë duhet ta kthejmë vështrimin nga Kosova Lindore, duke kërkuar që edhe atje të zbatohen të njëjtat parime e norma me ata që kërkohen për serbët në Kosovë. E kjo duhet të jetë e qartë për të gjithë ata që bëjnë politikë dhe analiza politike. Sepse të flasësh është një gjë e të arsyetosh sipas të drejtës është një gjë tjetër.

Prandaj nga ky manifestim do të apeloj për unitet gjithëshqiptarë, me qëllim që të tregojmë forcën tonë. dhe të tregosh forcën nuk do të thotë të tregohesh agresiv, por të tregohesh i dinjitetshëm dhe i qëndrueshëm.

Të nderuar pjesëmarrës!

Është privilegj të jesh me ju në ditët e shenjta të kombit. Ju diaspora në të gjitha vendet ku jeni na keni bërë krenar. Na keni përfaqësuar me dinjitet dhe me shumë mençuri, pavarësisht se ne atje në trojet etnike nuk iu kemi vlerësuar sa duhet e si duhet, por ju jeni falës, e doni shumë atdheun, e për rrjedhojë sa herë që lind nevoja ju jeni aty me ne. Këtë e treguat në Luftën Çlirimtare të Kosovës, në Luftën për çlirimin e Kosovës Lindore, ashtu edhe në luftën e Ushtrisë Çlirimtare kombëtare. Unë e di mirë se ju edhe sot e edhe nesër jeni aty me ne për të kapërcyer çdo vështirësi.

Rroftë kombi shqiptar!

Lavdi Ushtrive Çlirimtare të kombit shqiptar!

Lavdi dëshmorëve të atdheut!

Nderim për ju!

Faleminderit!





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Topalli dhe Krasniqi: Synojmë rezultate pozitive

Dy futbollistët e krijuar në Kosovë, Jetmir Topalli dhe Ermal Krasniqi janë shprehur të lumtur që kanë marrë ftesë nga përzgjedhësi Giresse për të përfaqësuar Kosovë. Ata më këtë rast janë shfaqur mjaftë optimist për ndeshjet e radhës që Kosova i zhvillon në këtë muaj ndaj Rumanisë dhe Bjellorusisë, në kualifikimet për "Euro 2024"



**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 QERSHOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Alain Giresse ka pasur komplet futbollistët në stërvitjen e radhës, e cila është mbajtur nëpër mot me shi në Kampin Nacional në Hajvali. Përkushtimi i "dardanëve" në stërvitje është maksimal, derisa dëshira që në dy ndeshjet e radhës të marrin rezultat pozitiv është e madhe, të vetëdijshëm për faktin se vetëm në këtë mënyrë mbesin në garë për kualifikim në "Euro 2024". Dy të grumbulluarit për herë të parë në përfaqësues për ndeshje zyrtare, Jetmir Topalli dhe Ermal Krasniqi janë shprehur të lumtur që janë pjesë e grumbullimit për dy përballjet shumë të rëndësishme kundër Rumanisë dhe Bjellorusisë. "Më të vërtetë është ndjenjë e mirë të jem këtu dhe i falënderoj për ftesën përzgjedhësin dhe Federatën, e gjithashtu i falënderoj lojtarët për pritjen shumë të mirë. Ndihem sikur të isha për kohë të gjatë pjesë e Kombëtares. Jemi si familje dhe jam shumë

i lumtur dhe shpresoj ta ndihmoj ekipin në mënyrën më të mirë të mundshme. Gjendja e ekipit është e mirë, jemi duke u përgatitur maksimalisht me ritëm të ngadaltë, por në mënyrën më të mirë të mundshme dhe shpresoj që në ndeshjen ndaj Rumanisë ta bëjmë atë që dimë më së miri", ka thënë Topalli, duke shtuar: "Objektivat tona tashmë dihen dhe do të futemi në lojë me objektiv të qartë për të fituar si në ndeshjen ndaj Rumanisë ashtu edhe ndaj Bjellorusisë. Kështu që të gjithë lojtarët jemi të vetëdijshëm se duhet të futemi për ta fituar ndeshjen dhe do ta bëjmë maksimumin për ta arritur një gjë të tillë. Pres nga 'Dardanët' të jenë në numër sa më të madh në stadium e të na përkrahin, e ne ta kryejmë punën tonë që t'i bëjmë ata të lumtur". Ndërkaq, Ermal Krasniqi ka thënë se ëndërr e çdo futbollist është të luaj për vendin e vet. Ai ka bërë të ditur se të gjithë futbollistët "dardanë" janë shumë të motivuar dhe synojnë rezultate pozitive në dy ndeshjet e këtij muaji. "Është ëndërr për çdo futbollist të luaj

për shtetin e tij. Përgatitjet po shkojnë mirë dhe lojtarët po duken në formë. Mezi presin ditën e ndeshjes dhe janë të motivuar maksimalisht dhe besoj se do të arrijmë të marrim rezultate pozitive nga këto dy ndeshje. Janë dy ndeshje që duhet t'i fitojmë, sepse është treni i fundit për ne dhe duhet ta japim të gjithë maksimumin për të arritur rezultatin pozitiv. Do të hyjmë në fushë të fitojmë ndeshjet për t'i gëzuar 'Dardanët', sepse ata janë lojtari i 12-të për neve në fushë", ka thënë Krasniqi.

### Rrahmani ftohet në Përfaqësues

Përzgjedhësi Alain Giresse e ka ftuar në grumbullimin e Përfaqësues sulmuesin e FC Ballkani, Albion Rrahmani. Ai do t'i bashkohet ekipit sot dhe do të jetë në dispozicion të trajnerit për dy ndeshjet kualifikuese kundër Rumanisë dhe Bjellorusisë. Albioni gjatë edicionit të sapopërfunduar spikati me lojëra të mira dhe ishte golashënuesi më i mirë në Albi Mall Superligë. Ai ka qenë pjesë e "Dardanëve" edhe në grumbullimin e muajit mars.

### SHKURT

## FIBA e dënon përjetësisht gjyqtarin Daut Mehmeti

Shtëpia më e madhe e basketbollit FIBA, ka marrë vendim që ta përjashtojë me pezullim të përjetshëm gjyqtarin kosovar Daut Mehmetin. Sipas njoftimit të FIBA-s, Mehmeti, u ndëshkua me pezullim të përjetshëm për thyerje të Kodit të Sjelljes dhe Integritetit të Federatës Botërore. Sipas faqes zyrtare të FIBA-s, sanksioni tashmë është vendosur ndaj gjyqtarit. Arsyeja që ka sjellë dënimin për gjyqtarin 37-vjeçar janë bastet dhe trukimet e disa ndeshjeve që ai ishte thirrur për të gjykuar. Sipas bgbasket.com, Mehmeti ka gjykuar gjashtë ndeshje të Maccabi Haifas në nëntë paraqitjet e tij të fundit në fushë. Njoftimi për sanksionin përmend një "pezullim nga kryerja e një funksioni" dhe një "ndalim të pjesëmarrjes në të gjitha aktivitetet e FIBA-s apo FIBA-s" për shkelje të Kodit të Etikës dhe Integritetit të federatës, për sa i përket basteve dhe manipulimit të garave.

## Kapra vazhdon me Ballkanin

Albin Kapra ka nënshkruar kontratë të re me FC Ballkanin. 23-vjeçari do të jetë i lidhur me klubin nga Suhareka deri në verën e vitit 2026. Lajmi është bërë i ditur nga klubi kampion i Kosovës, përmes një postimi në faqen zyrtare të klubit. "Albin Kapra vazhdon me kampionët. Edhe për tri vite të tjera, futbollisti Albin Kapra do të vazhdojë t'i mbrojë ngjyrat e FC Ballkanit. Lojtari me kualitete fantastike si në fazën mbrojtëse, ashtu edhe në atë sulmuese, do të jetë pjesë e skuadrës deri në vitin 2026. Klubi i uron Albinin edhe shumë suksese të përbashkëta në arritjen e synimeve tona", thuhet në njoftimin e FC Ballkani.

## Rodri, lojtari i sezonit në Ligën e Kampionëve

Rodri është shpallur lojtari më i mirë i sezonit 2022/23 në Ligën e Kampionëve. Paneli i Vëzhguesve Teknik i UEFA-s ka zgjedhur mesfushorin e Manchester Cityt si lojtarin e sezonit. 26-vjeçari u paraqit në 12 ndeshje këtë sezon në Ligën e Kampionëve, teksa shënoi dy gola. Spanjollit ishte golashënues në fitoren 1:0 në finalen ndaj Interit, kurse golin tjetër e kishte shënuar në ndeshjen e parë çerekfinale ndaj Bayern Munichit, ndeshje e cila ishte fituar 3:0 nga "Qytetarët".

## Pensionohet Gentrin Begolli

Gentrin Begolli ka njoftuar se i ka dhënë fund karrierës si futbollist profesional. Begolli e ka cilësuar karrierën e tij të mbushur me kënaqësi dhe me plot sfida. Ai ka falënderuar familjarët, shokët dhe trajnerët me të cilët ka bashkëpunuar. "Përmes këtij postimi dëshiroj të ju njoftoj se pas 15 vitesh kam vendosur t'i jap fund karrierës si futbollist. Ka qenë një periudhë e mbushur përplot kënaqësi e gjithashtu edhe me sfida. E falënderoj krijuesin fuqiplote për secilën prej tyre. Njëheri, shfrytëzoj rastin t'i falënderoj familjarët, shokët, dhe të gjithë ish-bashkëlojtarët dhe trajnerët me të cilët kam pasur rastin të bashkëpunoj. Jam shumë i lumtur që në krahasim me periudhën kur e kam filluar karrierën, tashme futbollistët e rinj shohin shumë më shumë perspektive për t'i përmbushur ëndrrat e tyre edhe në arenën ndërkombëtare. Për fund, jam i kënaqur që karrierën time po e përfundoj me trofeun e Kupës së Kosovës, me ç'rast shfrytëzoj rastin t'i uroj edhe 'Plisat' për këtë titull", ka shkruar Begolli.

## Nipi i Driton Kukës i sjell Kosovës medaljen e artë

Pejë, 11 qershor - Blin Kuka, i ka sjell Kosovës medaljen e artë. Ai ka marrë pjesë në garën e xhudos për kadet të mbajtur në Maqedoninë e Veriut. Kuka garoi

në kategorinë deri në 90 kilogramë. Xhudisti triumfoi me katër Ippon. E i kënaqur për nipin e tij mbeti edhe trajneri i njohur i xhudos Driton Kuka. "Javët e

fundit në pah qitën një vlerë të re në xhudo Kosovare. Medalje të arta erdhën edhe në klube tjera dhe tashmë kjo po tregon që me të rinj po punohet seriozisht në

shumë klube në mbarë vendin. Xhudo po rritet në çdo aspekt e kjo fal shtrirjes horizontale në krejt qytetet e vendit tonë", ka thënë Kuka.





**Ndërmarrja Publike Lokale  
"Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë**



Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" SH.A. shpall këtë:

## KONKURS PUBLIK

### I. Zyrtar/e Administrativ/e, një (1)

#### Departamenti i Administratës

##### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përfaqësimi i Ndërmarrjes në këmbimin e informatave të cilat lidhen me procesin dhe zhvillimet e punës brenda Ndërmarrjes me qëllim të krijimit të një imazhi (opinionit) sa më të mirë për Ndërmarrjen;
- Përgjegjësia për punën në lëshimin e marrëveshjeve (kontratave), verifikimi i dokumentacionit të nevojshëm për vendparkingje;
- Mbajtja e evidencës për çdo marrëveshje (kontratë) për vendparkingje;
- Përgjegjësia për zbatimin e rregullave dhe urdhëresave të Kryeshefit Ekzekutiv.

##### Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollim universitar;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negociimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

##### Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

### II. Zyrtar/e Ligjor/e, një (1)

#### Departamenti Ligjor

##### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Siguron përfaqësimin gjyqësor për mbrojtjen e Ndërmarrjes në të gjitha shkallët administrative, civile, penale, përmbarues në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Ofrimin e ndihmës juridike dhe udhëzimeve në aspektin ligjor;
- Monitoron dhe aplikon rregullat dhe aktet ligjore që ndërlihen me Ndërmarrjen si dhe merr pjesë në hartimin, përpilimin, ndryshimin e rregullave dhe procedurave të Ndërmarrjes;
- Ofron udhëzime ligjore për çështje rregullative-ligjore për Ndërmarrjen si dhe përcakton lëndët me rëndësi dhe propozon masa juridike për mbrojtjen e Ndërmarrjes tek instancat gjyqësore;
- Koordinon punën me të gjitha organet shtetërore, gjykata, agjencione të ndryshme, përmbaruese, vlerësuese dhe zyrtarë tjerë relevant;
- Ndihmon në përgatitjen e akteve dhe përcjellë ndryshimet në legjislacionin në fuqi.

##### Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi universitar (Juridik);
- Së paku dy (2) vite përvojë pune;
- Aftësi për të përpiluar akte juridike;
- Njohuritë e legjislacionit në fuqi;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negociimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

##### Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimime kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

### III. Zyrtar/e i/e Financave, një (1)

#### Departamenti i Financave, Divizioni i Kontabilitetit dhe Analizave Financiare

##### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitja e pasqyrave financiare mujore dhe raporteve të ndryshme duke mbledhur dhe analizuar informatat e kontabilitetit;
- Pranon, regjistron dhe mirëmban faturat dhe dokumentet burimore në dosje dhe sigurohet që ato janë të plota;
- Njohja e programeve financiare dhe t'i paraqesë në kohë dhe me saktësi llogaritë e inventarit, klientëve, furnitorëve, etj.;
- Administrimi i procedurave financiare dhe garanton saktësinë e regjistrimit të veprimeve financiare;
- Përgatitja e të dhënave të Ndërmarrjes për auditim në fundvit si dhe çfarëdo tjetër detyrë të përcaktuar nga Kryeshefi Ekzekutiv;
- Kryen dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës.

##### Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollimi universitar (Ekonomik);
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negociimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

##### Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV-në;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbi të kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimime kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

### IV. Inkasant/e, shtatë (7)

#### Departamenti i Operimeve, Divizioni i Parkingjeve me Laura

##### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhimi i faturave të faturave, të hollave dhe besueshmëri, cilësi të komunikimit me konsumatorët, aftësi të marrjes së përgjegjësisë materiale;
- Identifikimi i konsumatorëve të rinj, përcjellja e gjendjes së konsumatorëve ekzistues, të ngarkohet me fatura, të inkasojë dhe dorëzojë pazarin ditor çdo ditë;
- Mbajtja e shënimeve për secilin konsumator, kërkesave, ankësive, sugjerimeve dhe delegimin e tyre për shqyrtim;
- Menaxhimi i vonësive në pagesa së bashku me udhëheqësin e sektorit;
- Realizimi i normës së inkasimit sipas akteve normative në fuqi të Ndërmarrjes.

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Diploma e shkollës së mesme;
- Preferohet të ketë përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Preferohet të ketë shkathtësi kompjuterike elementare.

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbitë kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

**V. Teknik/e i/e IT-së, dy (2)****Departamenti i Teknologjisë Informative****Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Instalimi, konfigurimi, mirëmbajtja e rrjetit dhe pajisjeve të IT-së (PC, Printer, Fotokopje, etj.);
- Zhvillimi i Software dhe mirëmbajtja e faqes zyrtare;
- Mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemeve të reja që mund të zhvillohen brenda IT-së për nevojat e Ndërmarrjes;
- Ofrimi i ndihmës për punëtorët e ndërmarrjes në rast të përdorimit të pajisjeve dhe programeve të IT-së;
- Ndihmon në futjen e shënimeve në sisteme të ndryshme si faqe zyrtare dhe sisteme tjera;
- Intervenon sipas kërkesave të zyrtarëve në të gjitha rastet për evitimin e prishjeve teknike në pajisjet kompjuterike.

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Shkollim universitar;
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Certifikatë për TI;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbitë kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

**VI. Receptonist/e, një (1)****Departamenti i Zhvillimit të Biznesit, Divizioni i Shërbimit ndaj Klientëve****Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Komunikimi me konsumatorët e shërbimeve të Ndërmarrjes në mënyrë të qartë dhe të saktë;
- Pranimi i telefonatave nga qytetarët dhe transferimi i telefonatave në zyret përkatëse sipas nevojës;
- Ofrimi i informatave për mënyrën e realizimit të pagesave dhe të pikave të shitjes së biletave fizike;
- Pranimi i ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve dhe dorëzimi i tyre për protokolim pranë zyrtarëve përgjegjës.

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Diploma e shkollës së mesme;
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur.

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbitë kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

**VII. Çertifikues/e, një (1)****Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Harton planet e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të Divizionit/Sektorit dhe ofon rekomandime lidhur me objektivat përkatëse;
- Udhëheqjen e grupeve punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet dhe kryen detyra të specializuara në fushën profesionale specifike, si dhe ndihmon stafin vartës në ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Analizon dhe vlerëson realizimin e objektivave dhe planit të punës të Njësisë, harton raporte mbi progresin e arritur dhe rekomandon përmirësime nëse kërkohet;
- Certifikon realizimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore të Ndërmarrjes;
- Siguron që kushtet e zbatueshmërisë së një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës;
- Siguron që shpenzimi i parasë publike sipas një kontrate publike të bëhet në pajtim me rregullat e KBFP dhe që prokurimi është në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik;
- Siguron që janë plotësuar kushtet e kontratës para se të bëhet pagesa dhe që kërkesa për pagesë është e koduar në zërin e duhur të shpenzimeve;
- Siguron që rregullat e KBFP dhe dispozitat tjera ligjore janë respektuar gjatë inicimit dhe realizimit të aktivitetit të prokurimit dhe procedimit të shpenzimeve;
- Identifikon dhe raporton me shkrim pranë ZKF dhe cilit do zyrtar tjetër të rangut të lartë në Ndërmarrjen mbi të gjitha rastet e mos-respektimit të këtij ligji. Rastet e mos-respektimit të Ligjit mbi Prokurimin Publik gjithashtu duhet t'i raportohen Auditorit të Përgjithshëm. Zyrtari Certifikues mban shënime gjithëpërfshirëse me shkrim mbi të gjitha rastet e mos-respektimit të ligjit për së paku shtatë (7) vite. (këto ndryshime reflektojnë në Skemën Organizative, Rregulloren mbi Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Udhëzimin mbi Përshkrimin e Detyrave për Departamente dhe Zyra).

**Kualifikimi dhe përgatitja profesionale**

- Shkollim universitar (Ekonomik);
- Së paku dy (2) vite përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

**Procedura e Konkurrimit**

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);

- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbitë kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

#### VIII. Zyrtar/e i/e Resurseve Njerëzore, një (1)

##### Departamenti i Personelit

##### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbështetë procesin e rekrutimit dhe seleksionimit, si informimin e kandidatëve për intervista dhe test me shkrim;
- Mirëmbajtja dhe përpunimin e të dhënave të punonjësve;
- Mirëmban bazën e të dhënave të Burimeve Njerëzore për pushime vjetore, mjekësore, të lehonisë dhe të tjera, si dhe sipas kërkesës dhe planifikimit të tyre përgatitë pushimet vjetore të stafit;
- Përgatitja raporte për listën e pagave bazuar në përpunimin e të dhënave për hyrje/dalje të punëtorëve;
- Mirëmbajtja e të dhënave të të punësuarve si dhe proceset, politikat dhe procedurat e Burimeve Njerëzore;
- Kalkulimi dhe dorëzimi i pagave të punonjësve për procedim;
- Mirëmban dhe azhuron dosjet personale;
- Ndihton në detyrat dhe operacionet e përditshme të funksioneve të Burimeve Njerëzore;
- Siguron ofrimin e mbështetjes administrative për menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Kryen punë dhe veprime të tjera që i cakton Menaxheri i Burimeve Njerëzore.

##### Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Shkollim universitar (Ekonomik);
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur;
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

##### Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbitë kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

#### IX. Zyrtar/e për Shërbime ndaj Klientëve, dy (2)

##### Departamenti i Zhvillimit të Biznesit, Divizioni i Shërbimit ndaj Klientëve

##### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës/e për punën në lëshimin e marrëveshjeve (kontratave), bën verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për vendparkingje;
- Realizon pagesat me para të gatshme për shërbimet ndaj konsumatorëve të Ndërmarrjes;

- Mban evidenca për çdo marrëveshje (kontratë) për vendparkingje;
- Informon klientët për datën e skadimit të regjistrimit;
- Përfaqësimin e Ndërmarrjes në këmbimin e informatave të cilat lidhen me procesin dhe zhvillimet e punës brenda Ndërmarrjes me qëllim të krijimit të një imazhi (opinion) sa më të mirë për Ndërmarrjen;
- Është përgjegjës/c për zbatimin e rregullave dhe urdhëresave të Kryeshefit Ekzekutiv.

##### Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

- Diploma e shkollës së mesme;
- Së paku një (1) vit përvojë pune;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe negocimi;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja në të shkruar dhe të folur
- Shkathtësi kompjuterike (Microsoft Office).

##### Procedura e Konkurrimit

Kandidati/ja për këtë pozitë, duhet të dorëzojë dokumentet si në vijim:

- Aplikacionin;
- CV;
- Dëshminë e shkollimit (kopje të noterizuar);
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj) dhe çertifikatën mbitë kaluarën kriminale;
- Vërtetimin tatimor nga ATK;
- Ekstraktin e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Letër motivimi.

**Kontratë pune: gjashtë (6) muaj punë provuese, me mundësi vazhdimi me kontratë për periudhë të pacaktuar në rast të vlerësimit pozitiv të performancës në punë.**

#### X. Zyrtar/e i/e Komunikimit Publik, një (1)

##### Divizioni i Komunikimit Publik

